# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6707
E premte, 16 shtator 2022
çmimi 0.40 €


## Lajçaku erdhi në Prishtinë “për ta çuar përpara dialogun”

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KUVENDI I KOSOVËS TË ENJTEN KA MBAJTUR SEANCËN E PARË PLENARE PËR SESIONIN VJESHTOR

# OPOZITA KËRKON NGA QEVERIA TË GJEJË ZGJIDHJE PËR GREVËN NË ARSIM



Në seancën e parë të Kuvendit të Kosovës të sesionit vjeshtor partitë opozitare kanë kërkuar nga kryeministri Albin Kurti që të gjejë zgjidhje sa më parë për përfundimin e grevës së mësimdhënësve dhe rikthimin e fëmijëve në shkolla. Liderët e opozitës kanë theksuar se përgjegjësja e vetme e thellimit të krizave në vend është qeveria Kurti



## MBROJTJA KËRKON QË SALIH MUSTAFA TË SHPALLET I PAFAJSHËM PËR TË GJITHA AKUZAT

FAQE 3



Shkruan: Ramush HARADINAJ

## ENERGJIA, KJO PLAGË E PASHËRUESHME E KOSOVËS!

FAQE 7

## AKTUALE



### KONJUFCA: TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA, PARAKUSHTE PËR FUNKSIONIMIN E DEMOKRACISË

F. 3

### KUVENDI I SERBISË MIRATON RAPORTIN PËR DIALOGUN ME KOSOVËN

F. 7

### SALI BISLIMI TAKON DREJTORIN E SIGURISË NË BERN, OFRON PËRKRAHJE PËR THAÇIN

F. 6



## EKONOMI



### PROJEKTLIGJI PËR PAGA DEL NË KONSULTIM PUBLIK, KËTO JANË KOEFICIENTET E PROPOZUARA

F. 8

### ODA EKONOMIKE E KOSOVËS PUBLIKON TË GJETURAT E STUDIMIT PËR SEKTORIN E RICIKLIMIT

F. 8

## SPORT



### TOVËRLANI PARAQITET SI PËRZGJEDHËS I KOSOVËS U21

F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Banka Evropiane e Investimeve i jep Ukrainës 500 milionë euro

**Bruksel, 15 shtator** - Banka Evropiane e Investimeve (EIB), krahu huadhënës i Bashkimit Evropian, tha se ka disbursuar 500 milionë euro për Ukrainën si pjesë e paketës së reagimit urgjent të solidaritetit për vendin.
EIB tha në një deklaratë, më 15 shtator, se fondet janë pjesë e një pakete prej 1.59 miliard eurosh për Ukrainën, e cila ka garanci nga buxheti i BE-së.
Me këto mjete synohet të ndihmohet Ukraina që t'i mbulojë nevojat prioritare të financimit afatshkurtër dhe të sigurojë riparime urgjente të rrugëve, urave dhe infrastrukturës hekurudhore të dëmtuar, thuhet në deklaratë.
Ministri i Financave i Ukrainës, Sergii Marchenko, tha se fondet janë "të rëndësishme" për stabilitetin ekonomik të vendit në mes të luftës, e cila tani është në muajin e saj të shtatë.
Kostoja e rindërtimit të Ukrainës pas pushtimit të Rusisë mund të arrijë në 750 miliardë dollarë, tha në korrik kryeministri ukrainas Denys Shmygal.
Në të njëjtin muaj, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se Bashkimi Evropian do të krijojë një platformë për ta koordinuar rindërtimin e Ukrainës. "Që nga fillimi i luftës Bashkimi Evropian ka mobilizuar rreth 6.2 miliardë euro (6.48 miliardë dollarë) në mbështetje financiare", kishte deklaruar ajo. "Dhe... më shumë do të vijnë. Ne do të angazhohemi në mënyrë thelbësore për rindërtimin afatmesëm dhe afatgjatë".
Pushtimi rus i Ukrainës ka nisur më 24 shkurt.




# Shefja e BE-së viziton Kievin për thellim të bashkëpunimit

**Kiev, 15 shtator** - Shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka shkuar të enjten në Kiev, për të diskutuar për bashkëpunim më të ngushtë në mes të Ukrainës dhe Bashkimit Evropian. "Jam në Kiev, në vizitën time të tretë që prej nisjes së luftës së Rusisë. Shumë gjëra kanë ndryshuar. Ukraina tani është kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian", ka thënë von der Leyen në Twitter para takimit me zyrtarë të lartë ukrainas, përfshirë presidentin e shtetit, Volodymyr Zelensky. "Do të diskutoj me Zelenskyn dhe kryeministrin Denys Shmyhal si t'i afrojmë njerëzit dhe ekonomitë teksa Ukraina bën përparim në rrugën për anëtarësim", ka thënë ajo.



Ukraina është bërë kandidate për anëtarësim në BE në muajin qershor, hap që Moska beson se ka qenë përpjekje e Perëndimit për ta izoluar Rusinë në nivel botëror pas nisjes së sulmit të paprovuar në Ukrainë në fund të muajit shkurt.
Shumica e vendeve të BE-së e kanë mbështetur Ukrainën prej nisjes së luftës, si dhe e kanë goditur Rusinë me disa valë të sanksioneve ekonomike.
Shumë vende anëtare të bllokut evropian i kanë dhënë Kievit armë të avancuara, të cilat i kanë ndihmuar ushtrisë ukrainase që ta rikthejë kontrollin mbi territoret që i ka pushtuar Rusia pak pas nisjes së luftës.
Zelensky, i cili më 14 shtator ka vizituar zonat e rikthyera nga ushtria ukrainase, ka thënë se rajonet që ka parë janë shkatërruar rëndë nga forcat ruse.
Në fillim të muajit shtator ushtria ukrainase ka nisur një kundërofensivë për ta rikthyer kontrollin e territoreve të pushtuara nga forcat ruse prej nisjes së luftës në fund të muajit shkurt.
Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se ushtria ukrainase kontrollon mbi 6 000 kilometra katrorë në rajonin e Harkivit dhe tani fokusi është te rajonet lindore.
Autoritetet ruse kanë thënë se forcat e tyre janë tërhequr nga rajonet e Harkivit për t'u përforcuar në rajonin e Donbasit, mirëpo ekspertët besojnë se Rusia ka dhënë arsyetim të ngjashëm edhe kur është tërhequr nga rajonet e Kievit në muajin mars.

# Kryeministrja suedeze dorëhiqet pas fitores së partive të djathta në zgjedhje

**Stokholm, 15 shtator** - Kryeministrja e Suedisë, Magdalena Andersson, ka thënë se do të japë dorëheqje pasi qeveria e saj është mposhtur në zgjedhjet e së dielës.
Koalicioni i saj i qendrës së majtë duket se do të fitojë 173 ulëse në krahasim me 176 ulëse sa pritet të fitojnë partitë e krahut të djathtë.
Këto parashikime janë bërë pas numërimit të 99 për qind të votave.
Lideri i Partisë së Moderuar, Ulf Kristersson, pritet ta formojë qeverinë e re.
Në bllokun e partive që pritet të vijnë në pushtet është edhe ajo e Demokratëve të Suedisë, parti e të djathtës ekstreme, e cila në fushatë ka pasur temë kyçe luftimin e të shtënave me armë zjarri nga bandat.
E krijuar nga një lëvizje neo-naziste në fund të viteve 1980, partia kundër migrimit, Demokratët e Suedisë, ka hyrë në Parlament me 5.7 për qind të votave më 2010, duke u rritur më pas në 17.5 për qind më 2018.
Rezultati përfundimtar pritet të konfirmohet pas rinumërimit të votave, praktikë standarde në Suedi. Megjithatë, Anderssoni e ka pranuar humbjen, dhe ia ka ofruar kryetarit të parlamentit dorëheqjen.
Në parlament ata kanë një apo dy ulëse më shumë. Është numër i vogël, por e krijon shumicën.
Anderssoni ka qenë kryeministrja e parë grua e Suedisë kur e ka marrë pozitën në fund të vitit të kaluar.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Mbrojtja kërkon që Salih Mustafa të shpallet i pafajshëm për të gjitha akuzat

HAGË, 15 SHTATOR - Mbrojtja ka kërkuar që Salih Mustafa të shpallet i pafajshëm për të gjitha akuzat të cilat rëndojnë mbi të dhe ka kërkuar lirim sa më të shpejtë të tij.

Avokati Julius von Bone ka thënë të enjten para trupit gjykues se Mustafa nuk ka kryer asnjëherë krime, por e ka vënë veten në rrezik për të tjerët duke i shërbyer objektivit të përgjithshëm të popullit të Kosovës për ta fituar pavarësinë.

Këtë von Bone e ka thënë gjatë deklaratës përfundimtare të mbrojtjes në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. “Mbrojtja kërkon shpallje jo fajtor të z. Mustafës për të gjitha akuzat për të cilat ai akuzohet. Ai nuk e ka kryer asnjë krim asnjëherë. Ai e ka vendosur veten e vet në rrezik për shumë njerëz, ndërkohë që i shërbente objektivit të përgjithshëm të të gjithë popullit të Kosovës, që ishte fitimi i pavarësisë për njerëzit që kishin luftuar për të qenë të lirë, për një periudhë të gjatë kohore. Zotëri Mustafa ka duruar një periudhë të vështirë dhe të gjatë të ndalimit të tij. Ai ka vuajtur paraburgimin, nuk ka shkelur asnjë prej urdhrave që janë përcaktuar nga trupi gjykues”, ka thënë avokati mbrojtës.

Mbrojtja e Mustafës ka bërë thirrje për drejtësi dhe ka shtuar se Mustafa duhet të lirohet sa më shpejt nga paraburgimi. “Z. Mustafa është i paraburgosur që prej shtatorit të vitit 2020. Zotëri Mustafa është baba dhe bashkëshort, ndërkohë që mbrojtja kërkon pafajësi për zotëri Mustafën për të gjithë akuzat e ngritura ndaj tij. Zotëri Mustafa duhet të lirohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Dëshiroj të theksoj se mbrojtja, i drejtohem këtu ZPS-së, se ne asnjëherë nuk kemi implikuar që viktimat të cilat kanë dhënë dëshmi në këtë çështje kanë fabrikuar apo sajuar historitë e tyre, siç ka deklaruar ZPS në deklaratën e vet, ne nuk e kemi bërë këtë në të kaluarën, nuk e bëjmë sot dhe nuk e bëjmë asnjëherë, për rrjedhojë është e gabuar të nxirret ky përfundim ose të thuhet një gjë e tillë. Vetë pozita dhe qëndrimi i mbrojtjes është tërësisht i ndryshëm dhe kemi mendime të ndryshme sa i takon vendit të pretenduar të krimit, apo gjërave që kanë ndodhur apo jo dhe nëse zotëri Mustafa ka pasur ndonjë lidhje ose jo me vendin ku mund të kenë qëndruar personat”, ka thënë ai.



Me këtë mbrojtja e ka mbyllur deklaratën përfundimtare të saj, ndërsa seanca ka vazhduar deklarimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar lidhur me çështjet që i ka ngritur pala mbrojtëse.

Në seancën e së martës prokuroria ka kërkuar që Salih Mustafa të shpallet fajtor për katër pikat e aktakuzës dhe të marrë një dënim prej 35 vjetësh burgim.

Në fillim të këtij procesi Salih Mustafa, ndaj të cilit rëndojnë akuza me pretendimin për krime lufte, ishte deklaruar i pafajshëm para trupit gjykues. Sipas Dhomave të Specializuara, “aktakuza e konfirmuar përcakton se afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në një kompleks ndalimi në Zllash, Kosovë, u kryen krimet e ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe të torturës kundër të paktën gjashtë personave”. Gjithashtu, në aktakuzë thuhet se “në një datë midis 19 prillit 1999, ose rreth kësaj date, dhe rreth fundit të prillit 1999, në atë vendndodhje u vra një i ndaluar”.

# Konjufca: Transparenca dhe llogaridhënia, parakushte për funksionimin e demokracisë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Nën ombrellën e Forumit për Transparencë Parlamentare dhe përkujdesjen e kryetarit Glauk Konjufca, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me një varg aktivitetesh, të enjten ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë. Në ceremoninë e hapjes morën pjesë kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, drejtoresha e NDI-së për Kosovë, Nancy Soderberg dhe koordinatorja e Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT), Arnhild Spence, përfaqësues të organizatave të tjera partnere, përfaqësues të shoqërisë civile dhe pjesëmarrës të tjerë të aktiviteteve të parapara.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, në fjalën e tij të rastit, theksoi se me anë të shënimit të kësaj dite synohet të vihen në pah arritjet shoqërore dhe vlerat e demokracisë në sistemet e qeverisjes demokratike dhe se, siç tha ai, Kuvendi si institucion ka dëshmuar përkushtimin e vet për gjithëpërfshirje, zgjerim të hapësirës dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile, mediet dhe qytetarët. “Kuvendi i Kosovës, ngjashëm sikurse në vitet e tjera, në këtë ditë organizon aktivitete që kanë për qëllim hapjen e Kuvendit për të gjithë qytetarët, ata të cilët e bëjnë të mundur jetësimin e zgjedhjeve dhe qeverisjen demokratike”, tha kryetari Konjufca.

Kreu i Kuvendit tha se nëpërmjet këtij aktiviteti Kuvendi synon ta rrisë transparencën dhe ta fuqizojë llogaridhënien në shërbim të qytetarëve. “Kuvendi synon ta bëjë promovimin e demokracisë, ta hapë dhe ta bëjë sa më transparent këtë institucion. Transparenca dhe llogaridhënia janë parakushtet kryesore për funksionimin e demokracisë. Po ashtu, synojmë t’i bëjmë sa më llogaridhënëse institucionet publike”, tha kryetari Konjufca.

Të pranishmëve iu adresua edhe drejtoresha e NDI-së për Kosovë, Nancy Soderberg, e cila, duke uruar për Ditën e Demokracisë, tha se ndihet krenare për punën e përbashkët dhe për arritjet që Kosova ka shënuar ndër vite. “Jam krenare për punën që ShBA-ja ka bërë në mbështetje të lirisë dhe demokracisë së Kosovës, si dhe për arritjet që




Kosova ka shënuar në ndërtimin e një demokracie sa më të fuqishme përgjatë njëzet vjetëve”, theksoi Soderberg.

Edhe koordinatorja e Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT), Arnhild Spence, në fjalën e saj theksoi se Dita e Demokracisë shënon një ngjarje shumë të rëndësishme për Kosovën, duke e vënë fokusin te funksionimi i lirë i medias dhe tek objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. “Për Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë ne duam ta theksojmë rëndësinë e një medie të lirë e plurale për t’i luftuar lajmet e rrejshme dhe gjuhën e urrejtjes, pastaj objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm kanë për qëllim të mos e lënë askënd prapa”, theksoi Spence.

Shënimi i Ditës së Demokracisë vazhdoi me panairin e shoqërisë civile, pastaj me garën e lojës së shahut nga personat e verbër, për t’u përfunduar edhe me aktivitete të tjera që afirmojnë demokracinë.



KUVENDI I KOSOVËS TË ENJTEN KA MBAJTUR SEANCËN E PARË PLENARE PËR SESIONIN VJESHTOR

# Opozita kërkon nga qeveria të gjejë zgjidhje për grevën në arsim

Në seancën e parë të Kuvendit të Kosovës të sesionit vjeshtor partitë opozitare kanë kërkuar nga kryeministri Albin Kurti që të gjejë zgjidhje sa më parë për përfundimin e grevës së mësimdhënësve dhe rikthimin e fëmijëve në shkolla. Liderët e opozitës kanë theksuar se përgjegjëse e vetme e thellimit të krizave në vend është qeveria Kurti

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

Prishtinë, 15 shtator - Kuvendi i Kosovës në seancën e parë të sesionit vjeshtor ka zhvilluar të enjten debat parlamentar për grevën e përgjithshme të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK).

Partitë opozitare kanë dhënë kritika në adresë të qeverisë Kurti për grevën në arsim, duke kërkuar zgjidhje nga qeveria për kthimin e nxënësve në shkolla.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se është përgjegjësi e qeverisë të gjejë zgjidhje për këtë padrejtësi që po u bëhet nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve. "Sot nuk është më çështja se kush ka të drejtë. Çështja është kush e zgjidh padrejtësinë. E padrejtësi s'po përjeton as ti kryeministër, as sindikatat. Padrejtësinë më të madhe sot po e përjetojnë nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit. Ky është roli yt dhe kjo është përgjegjësia jote", ka deklaruar kryetari i PDK-së.

Krasniqi ka theksuar se edhe pse nuk është përgjegjësi e opozitës, në këtë pikë do të marrin përgjegjësi bashkë me të. "Gjej zgjidhje. Po të mbështesim", theksoi ai.

Krasniqi ka thënë se kryeministri Albin Kurti është çelësi që duhet ta zgjidhë këtë problem. "Mënyra si i je qasur trajtimit të kërkesave të tyre (sindikatave) është e gabuar", ka deklaruar Krasniqi.

Lideri i PDK-së ka thënë se Kosova po kalon nëpër një vit të vështirë, i cili, si duket, do të mbahet mend si një vit i depresionit të shkaktuar nga krizat e njëpasnjëshme që e kanë kapluar vendin. Sipas tij, këto kriza janë duke gjetur një terren të lirë për të lulëzuar si pasojë e kësaj qeverie plotësisht të paaftë për t'i adresuar problemet me të cilat po ballafaqohet vendi.

Për ta kaluar këtë krizë ekonomike, lideri i PDK-së ka dhënë pesë propozime konkrete. "Për të kontribuar në zbutjen e nivelit të inflacionit, për t'i ndihmuar qytetarët të përballen me krizën dhe për të kontribuar në rigjallërimin e ekonomisë, ne kërkojmë që urgjentisht të ndërmerren këto pesë masa konkrete: 1. Të lirohen nga TVSh-ja të gjitha mallrat esenciale të konsumit për një periudhë gjashtëmujore; 2. Të lirohen nga akciza produktet e naftës për një periudhë gjashtëmujore, gjë e cila do ta ulë çmimin e naftës për 36 centë në litër; 3. Të lirohet nga TVSh-ja konsumi i energjisë elektrike për një periudhë gjashtëmujore dhe të subvencionohen me 25 % të vlerës faturat e familjeve që konsumojnë deri në 1200 kwh; 4. Të rriten pagat, pensionet dhe ndihmat sociale, për aq sa norma e inflacionit (rreth 15 për qind); 5. Të lejohet tërheqja deri në 30 % e kursimeve pensionale nga Trusti, me kushtin që gradualisht të rimbursohen mjetet e kontribuuesve që kanë më pak se 10 000 euro në llogarinë e kursimit pensional", ka thënë Krasniqi.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se rreth 25 mijë mësimdhënës janë në grevë, ndërkaq rreth 318 mijë nxënës tash e tri javë nuk vijojnë mësimin. "Të kesh 318 mijë fëmijë e 25 mijë mësimdhënës jashtë sistemit arsimor është emergjencë kombëtare. Të kesh familje kosovare që nuk organizojnë dot përditshmërinë e tyre meqë nuk kanë ku t'i lënë fëmijët, është emergjencë kombëtare. Emergjencë që duhet të ngrehë alarme e duhet të sjellë vendimmarrje. Kjo emergjencë kërkon, para së gjithash, dialog dhe nga dialogu kompromis. Janë njerëzit tanë, familjet tona, mësimdhënësit e nxënësit tanë", ka thënë ai.

Abdixhiku ka thënë se sot nuk ka gjë më të rëndësishme sesa të dialogosh me ta e për ta e të gjesh një zgjidhje. "Kryeministri, megjithatë, ka zgjedhur një rrugë tjetër. Ai ka zgjedhur polarizimin. Fillimisht duke komunikuar në distancë me ta, e më pas duke lëshuar fletërrufe nga ideologët partiakë që përfaqësuesit sindikalë me të cilët përndryshe bashkëpunonte vetë sa ishte në opozitë, i portretizon si shërbëtorë të Serbisë, mësimdhënësit në masë si analfabetë, e kundërshtarët politikë në opozitë, komunat, mediet e armiqtë e padukshëm, si organizatorë të grevave me qëllim të rrëzimit të qeverisë. Duhet të kesh një hall të madh që ta ushqesh këtë krizë. Duhet të jesh tërësisht i shkëputur nga realiteti në vend për të gjetur fajtorë nga Serbia deri tek opozita për një problem që, megjithatë, bërtet. Bërtet për zgjidhje. Për Lidhjen Demokratike të Kosovës. Përgjegjësi i vetëm për këtë krizë ka adresë në qeveri", ka thënë Abdixhiku.

Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk është unike pasi është duke e ndarë popullin se "kush është me Albin Kurtin e kush është me Rrahman Jasharaj".

Deputeti Tahiri ka thënë se qëllim

# Lajçaku erdhi në Prishtinë "për ta çuar përpara dialogun"



**Prishtinë, 15 shtator** - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka ardhur të enjten për vizitë në Prishtinë. Ai ka bërë me dije se qëllimi i vizitës së tij në Prishtinë është për ta çuar përpara procesin e dialogut.

Lajçak ka folur shkurt për gazetarët pas takimit që ka zhvilluar të enjten me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Ai ka treguar se me Kurtin ka biseduar për "vazhdimin e dialogut" dhe për takimin e tij të radhës me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Kurti dhe Vuçiqi janë takuar për herë të fundit në Bruksel më 18 gusht. "Takimi i radhës do të zhvillohet sapo të përgatitet", ka thënë Lajçak. "Kjo është një nga arsyet përse jam sot këtu. Duam të sigurohemi që takimi të ketë substancë dhe do të prodhojë diçka. Të dy udhëheqësit janë të gatshëm të takohen, BE-ja është gati t'i mirëpresë, por po e përgatisim agjendën", ka thënë Lajçaku, pa dhënë datë korrekte.

Lajçak ka theksuar se nuk do ta vazhdojë vizitën në Serbi, por fillimisht do të kthehet në Bruksel.

Ai ka thënë se mund ta takojë Vuçiqin në Nju-Jork aty ku, javën e ardhshme, nis punimet Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

---

tjetër është për t'i përçarë sindikatat të cilat ende nuk ka mundur kryeministri Kurti t'i kapë. "Sikurse që ka vepruar me bordet e ndërmarrjeve publike dhe të agjencive të pavarura, gjithandej globit shohim shtete dhe qeveri që kanë marrë masa për t'u ballafaquar me krizat. Qeveria jonë është e zënë me shpërfaqjen e pashembullt të një arrogance dhe, për më keq, për prodhimin e krizave një pas një. Sot jemi duke folur për një krizë serioze, e cila lidhet me fëmijët tanë dhe e cila e kërkon një zgjidhje. Kjo papërgjegjësi e qeverisë tashmë po thellon krizën në çdo aspekt", ka thënë Tahiri.

E kryeministri Albin Kurti para deputetëve ka përmendur pakot që ka shpërndarë në mandatin qeverisës. Duke folur për grevën në vend, ai ka thënë se dialogu me sindikata nuk ka munguar, por ka thënë se kërkesat e tyre janë të parealizueshme. "Me sindikatat kemi pasur takime e komunikim të vazhdueshëm. Janë zhvilluar mbi 30 takime në mes të qeverisë e sindikatave. Me krerët e SBAShK-ut takohet ministrja e Arsimit, me krerët e BSPK-së jam takuar unë. Takimin e fundit që pata ishte me Këshillin Grevist. Dhe është zhvilluar me iniciativë timen", ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se nuk është problemi te mungesa e komunikimit, por ka një mospajtim themelor mes qeverisë dhe sindikatave. "Nuk është problemi te mungesa e komunikimit apo tek arroganca, por kemi një mospajtim themelor sepse unë jam i bindur se në këtë krizë duhet të dalim përmes pakos që e mundëson përballjen me inflacion e jo përmes kërkesave partikulare derisa të votohet Projektligji për Paga", ka thënë Kurti.

Kryeministri ka shtuar se nuk janë të pranueshme kërcënimet apo shantazhet në këtë rast. "Nuk mund të thuhet që ne i mirëmbajmë në mënyrë të ligjshme financat shtetërore nëse një grupi të caktuar ia plotësojmë kërkesën që t'i japim një shtesë të caktuar derisa të votohet Projektligji për Paga. Përballje me inflacion po, mirëpo kërcënim apo shantazh i dua kaq para për çdo muaj derisa të kalojë projektligji, nuk bën. Ai 50 euro është më i madh sesa përqindja e rritjes ekonomike kur përkthehet në pagën e mësimdhënësit", tha kryeministri Kurti. Ai ka shtuar se i kanë marrë për bazë të gjitha kërkesat dhe janë përpjekur t'i akomodojnë në projektligjin që është në diskutim publik.

Kryeministri shtoi se nuk është e çuditshme që opozita po e mbështet grevën. "Po shihet komplet opozita e mbështet grevën. Për bindjen time, nuk është e rastësishme që bartës i këtij mocioni është deputeti më shurdhues", ka deklaruar Kurti.

## Kuvendi miraton në parim Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes dhe dy projektligje për FSK-në

Projektligji për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Projektligji për FSK-në dhe Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes janë miratuar në parim pasi kanë marrë votën për nga shumica e deputetëve të Kuvendit. Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, për Projektligjin për Shërbim në FSK ka thënë se shqyrtimi dhe miratimi i këtij projektligji është i nevojshëm për krijimin e bazës ligjore për të drejtat dhe obligimet për pjesëtarët e FSK-së. Sipas memorandumit shpjegues, ky projektligj rregullon kushtet e përgjithshme të shërbimit në Forcën e Sigurisë të Kosovës. Pra, sipas këtij ligji, përcaktohet shërbimi i pjesëtarit të FSK-së sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara në këtë ligj në përmbushje të kompetencave dhe detyrave kushtetuese dhe ligjore. Në parim, ky projektligj ka marrë 80 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, ndërsa Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka marrë 74 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Deputeti i PDK-së, Hysen Berisha, ka kërkuar nga ministri Mehaj të kërkojë më shumë buxhet për FSK-në. Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës rregullon kompetencat, organizimin dhe funksionimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Pra, sipas këtij ligji, Forca e Sigurisë së Kosovës mbron sovranitetin dhe integritetin territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës. Ndërsa Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes ka marrë mbështetjen e 76 deputetëve dhe është miratuar në parim. Edhe për këtë projektligj të gjithë deputetët votuan për. Sipas memorandumit shpjegues, Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes ka rregulluar kompetencat dhe fushëveprimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të ministrit të Mbrojtjes. Po ashtu, ky ligj ka rregulluar edhe përbërjen e personelit të Ministrisë së Mbrojtjes, personel ky ushtarak dhe civil. Pra, sipas këtij ligji, Ministria e Mbrojtjes është organ i administratës shtetërore i përbërë nga personeli ushtarak dhe civil dhe se strukturat apo njësitë e Ministrisë së Mbrojtjes janë të gërshetuara në të gjitha rastet, ku disa udhëhiqen nga personeli ushtarak, disa nga personeli civil, por që të gjitha strukturat kanë personel civil dhe ushtarak.



## Sekuestrohen 1 648 litra tretës në Mitrovicë të Veriut

**Prishtinë, 15 shtator** - Pas pranimit të informacioneve inteligjente se nga Serbia është futur mall i kontrabanduar në veri të Kosovës, policia ka angazhuar njësi përkatëse dhe përmes njësitit të trafikut rrugor të Drejtorisë Rajonale të Policisë Mitrovicë jugu në fshatin Vinarc të Mitrovicës ka lokalizuar automjetin transportues me të cilin dyshohej se po bartej malli i kontrabanduar.

Drejtuesi i automjetit gjatë tentimit të shmangies nga policia ka dalë nga rruga dhe ka braktisur automjetin. Gjatë kontrollit të automjetit është gjendur tretës i llojeve të ndryshme me peshë të përgjithshme prej 1 648 litrash.

Automjeti së bashku me mallrat ilegale janë sekuestruar nga policia në Mitrovicë dhe pastaj i është dorëzuar Doganës së Kosovës. Rasti është duke u trajtuar nga zyrtarë të Doganës së Kosovës.



# Sali Bislimi takon drejtorin e sigurisë në Bern, ofron përkrahje për Thaçin

**Bern, 15 shtator** - Veprimtari Sali Bislimi, i cili jeton dhe vepron në Zvicër, dhe i cili është drejtor i zyrës ligjore First-consulting.ch në Bern dhe Delemont të Zvicrës, ka zhvilluar takim me drejtorin e sigurisë në Bern, Reto Nause.

Bislimi dhe Nause kanë diskutuar për zhvillimet në Kosovë, sidomos për Gjykatën Speciale, ku në Hagë po mbahen në paraburgim udhëheqësit e UÇK-së, një ndër ta ish-presidenti Hashim Thaçi.

Nause i ka thënë Bislimit se është i gatshëm të ofrojë siguri të përkohshme për ish-presidentin Thaçi në Bern deri në gjykimin e tij. “Takim të ngrohtë miqësor me drejtorin e sigurisë të kryeqytetit Bern, z. Reto Nause! ‘Nëse Konfederata Zvicerane më pyet, unë me kënaqësi pranoj sigurinë e përkohshme të presidentit Thaçi në Bern deri në gjykimin e tij’. Qyteti ynë Berni ka traditë mikpritjen dhe strehimin që e ka dëshmuar në të gjitha kohët. Presidenti ynë është i pafajshëm. Koha do të dëshmojë. Ai ka jetuar në Zvicër dhe këtu ka prekur vlerat e lirisë dhe demokracisë, dhe me vete i ka bartur për t’i kultivuar edhe për popullin e tij! Faleminderit miku, ynë Reto! Në kohë të vështira dëshmohet miqësia! Gur, gur do të bëjmë mur. Kosova dhe shqiptarët liridashës nuk ta harrojnë. Misioni vazhdon!”



# Kuvendi i Serbisë miraton raportin për dialogun me Kosovën



**Prishtinë, 15 shtator** - Kuvendi i Serbisë miratoi mëngjesin e së enjtes raportin për dialogun me Kosovën. Për miratimin e dokumentit të titulluar “Raporti për procesin e negociatave me ‘institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes’ në Prishtinë”, votuan 205 deputetë, ndërsa kundër ishin 57. “Raporti është i shkruar në 50 faqe dhe liston aktivitetet në kuadër të përgatitjes dhe realizimit të negociatave”, përfshirë: Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, policinë, gjyqësorin, energjinë, odat ekonomike, transportin e mallrave të rrezikshme, si dhe të zhdukurit që gjenden në kapitullin e fundit. Debati në Kuvendin e Serbisë për këtë raport zgjati dy ditë.

Gjatë prezantimeve të tij, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës. Ai, po ashtu, shtoi se duhet të gjendet një zgjidhje realiste për Kosovën dhe se politika reale nuk mund të bazohet në mite.

Partia më e madhe opozitare në Serbi, Partia e Lirisë dhe Drejtësisë, nuk votoi për miratimin e raportit.

Zyrtari i lartë i kësaj partie, Borko Stefanoviq, u tha gazetarëve se raporti nuk përmban propozime për zgjidhjen e problemit të Kosovës.

Deputeti i vetëm shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, gjatë prezantimit të tij tha se Kosova është e pavarur nga Serbia.

## KOMF-i kërkon përfshirjen e fëmijëve dhe prindërve në dialogun për fillimin e mësimit

**Prishtinë, 15 shtator** - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF, i cili përfaqëson 34 organizata joqeveritare, duke marrë shkas grevën në arsim dhe mungesën e një zgjidhjeje për fillimin e mësimit prej tashmë dy javësh, ka dërguar në Qeverinë e Republikës së Kosovës kërkesën që në kuadër të dialogut të përfshihen të gjitha palët, sidomos fëmijët dhe prindërit të cilët janë të dëmtuar drejtpërdrejt nga ndërprerja e mësimit.

KOMF-i konsideron se qasja e bisedimeve vetëm nga të dyja palët (qeveri dhe SBAShK) po anashkalon dhe harron interesin më të mirë të fëmijëve, të drejtën për arsim dhe dëmet që tashmë janë shkaktuar te fëmijët. “Një dialog me përfshirjen e fëmijëve, prindërve dhe të palëve të tjera, do të siguronte që interesi më i mirë i fëmijës të jetë konsideratë parësore përgjatë gjithë procesit”, thuhet në komunikatën e KOMF.

# Energjia, kjo plagë e pashërueshme e Kosovës!

Shkruan: Ramush HARADINAJ



Në shtatorin e vitit 2017, gjendja elektro-energjetike ne Kosovë, ishte katastrofike. Më e vështirë se sa që është aktualisht. Kishin shteruar rezervat e thëngjillit dhe ekskavatorët nuk gërmonin më. Termocentralet e Kosovës nuk prodhonin rrymë e Kosova shpenzonte miliona euro duke mos prodhuar e duke e blerë rrymë.
Arsyetimi ishte se nuk ishin shpronësuar banorët në Shipitullë!
Në fakt që në vitin 2014 Qeveria e Kosovës kishte marrë një vendim për shpronësimin e 54 hektarëve tokë ku gravitonin 20 shtëpi, për të hapur minierën e re, por vendimi nuk ishte realizuar asnjëherë dhe në ata 54 hektarë ishin ndërtuar gjithsej 226 shtëpi. Kishin mbirë si kërpudhat pas shiu, natyrisht kjo edhe sepse aty i kishin futur duart grupe të ndryshme interesi, që nga vet pushteti i atëhershëm e deri te tyxharët e energjisë.
Kosova nuk prodhonte rrymë e Banka Botërore kërcënonte se do të tërhiqej nga çdo lloj investimi në sektorin e energjisë.
Kjo ishte gjendja që unë e kisha trashëguar me ta marrë detyrën e Kryeministrit.
Duke qenë se situata ishte e rëndë e Kosova po hynte në dimër, pata kaluar javë të tëra në KEK e me banorët e zonës, në kërkim të një zgjidhjeje.
Në një raport të Bankës Botërore thuhej se nëse Kosova nuk do të bënte një zgjidhje të shpejtë do të detyrohej të paguante mbi 150 milionë euro për blerje të energjisë, ndërkaq parallogaria e shpronësimit ishte 20 milionë.
Kështu duke analizuar përfitimet e rreziqet, vendimi im i parë si Kryeminister ishte që të shpronësoheshin banorët, që KEK-u të rikthehej në prodhim me mbi 900 megavatë, që të mos shtrenjtohej rryma dhe që Kosova t'i shpëtonte rreth 150 milionë euro.
Duke e parë se situata elektro-energjetike edhe sot është e rëndë dhe mund të shkojë drejt kolapsit total, i pata kërkuar kryeministrit: që ministrat e tij të kalojnë më shumë orë pune në KEK, që të "mërdhijnë" duke kërkuar zgjidhje; që ta rishikojë projektin e Kosovës së Re; që ta rishikojë projektin e gazsjellësit Shkup-Prishtinë; që të bëjnë marrëveshje për blerje të energjisë sa nuk është bërë tepër vonë…
Por nga gjithë këto e masa të tjera emergjente e afatgjate për përballjen e kolapsit të mundshëm energjetik, ai e ministrat e tij kanë vendosur që të navigojnë në internet dhe të gjejnë modele të kursimit të energjisë, e t'ia kalojnë popullit për t'i lexuar. Dhe natyrisht të mos harrojnë të na thonë se "Ky dimër do të jetë i rëndë"!
Plaga energjetike e Kosovës, që kullon, nuk shërohet me këshilla nga interneti, por me vendime të mëdha të Kryeministrit.
Luaj nga vendi Albin Kurti, mos u tut!







# Policia arreston tre persona të dyshuar për kontrabandim të migrantëve

**Prishtinë, 15 shtator** - Policia e Kosovës, me qëllim të parandalimit të aktiviteteve kriminale dhe migrimit ilegal në pikat kufitare, ka hartuar planin operativ "Migrim i parregullt". Referuar këtij raporti, janë shtuar patrullimet dhe vëzhgimet në terren për identifikim dhe arrestim të personave të dyshuar, kryes të veprave penale. "Me datën 14.09.2022 rreth orës 21:20 njësia policore nga policia kufitare Vërmicë - Drejtoria Rajonale Gjakovë, gjatë zbatimit të planit operativ të lartcekur, në fshatin Shkozë ka ndaluar dy automjete të dyshuara taksi me targa vendore me drejtues dy të dyshuarit meshkuj kosovarë, të cilat ishin në lëvizje nga drejtimi Vërmicë - Prizren", ka njoftuar Policia e Kosovës.
Gjatë kontrollit të realizuar ndaj dy automjeteve janë hasur shtatë viktima shtetas egjiptianë dhe një shtetas palestinez i cili dyshohet se ka qenë i përfshirë në kontrabandimin e tyre.
Me urdhër të prokurorit tre personat e dyshuar, dy meshkuj kosovarë dhe një mashkull palestinez, janë dërguar në mbajtje për 48 orë, ndërsa viktimat janë dërguar në njësinë për migrim dhe të huaj për procedurat e mëtutjeshme.

# Drejtori i Policisë pret në takim ambasadorin e Shqipërisë

**Prishtinë, 15 shtator** - Në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës ushtruesi i detyrës i drejtorit të Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti, ka pritur në një takim zyrtar ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, Qemal Minxhozi. Gjatë këtij takimi u diskutua rreth forcimit të bashkëpunimit dhe partneritetit reciprok në mes të Policisë së Kosovës dhe Ambasadës së Shqipërisë, ku qëllimi i dyanshëm i palëve është avancimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit.



## 10 raste të reja me Covid në 24 orët e fundit




**Prishtinë, 15 shtator** - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 295 testimeve, janë konfirmuar 10 raste të reja me Covid. Sipas raportit të MSh-së, janë shëruar 51 persona. Raste aktive me Covid-19 janë 138. Në 24 orët e fundit kanë marrë vaksinën kundër Covidit 54 persona.

# Projektligji për Paga del në konsultim publik, këto janë koeficientet e propozuara

**Prishtinë, 15 shtator** - Projektligji për Paga për Sektorin Publik nga sot ka dalë në konsultim publik. Të gjitha palët do ta kenë mundësinë t'i japin mendimet e tyre për 15 ditë pune.
Duke e publikuar të plotë dokumentin, Zyra e Kryeministrit ka nxjerrë edhe koeficientet e propozuara për të gjithë punëtorët shtetërorë dhe sipas tyre është propozuar të jetë paga, shkruan "Telegrafi".
Koeficientin më të lartë, 18 e ka presidenti i vendit, pasuar nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese me 17.5, pastaj vinë kryeministri dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës me 17.
Kryetari i kryeqytetit është propozuar ta ketë koeficientin e rrogës 15 dhe nën të pasojnë kryetarët e komunave të tjera.
Në gjyqësor prin kryetari i Gjykatës Supreme me koeficient 17. Po aq është paraparë të jetë edhe për Kryeprokurorin e Shtetit.
Komandanti i FSK-së ka koeficient 15, kurse me 0.5 më pak vjen drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Në fund mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta është propozuar të vlerësohen me koeficient prej 5.8.
Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka njoftuar se Projektligji për Paga dhe ai për Zyrtarët Publikë nga e enjtja do të jenë në konsultim publik.



Sveçla në një konferencë për medie ka theksuar se për 15 ditë do të jetë i hapur periudha për komente dhe sugjerime për këto projektligje. "Janë zhvilluar me dhjetëra takime për ta dëgjuar secilin propozim dhe nga secila këto projektligje, ku nga sot i keni konkluzionet tona, ku do t'i presim komentet shtesë deri në finalizimin të tyre dhe procedim të tyre deri në instanca të tjera", ka theksuar Sveçla. Ai ka thënë se për 15 ditë pune, nga dita e enjte, të dy projektligjet do të jenë në konsultim publik, brenda së cilës kohë të gjithë do të kenë mundësi që ta adresojnë çdo koment apo sugjerim me këto projektligje, apo pjesë të caktuara.
Ligji i cili ishte shpallur i pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese pritej ta rregullonte pagesën e të punësuarve që marrin rroga nga buxheti i shtetit.
Vlera e pagës bazë llogaritej duke shumëzuar koeficientin e klasës së pagës me vlerën monetare të koeficientit prej 239 eurosh për vitin e parë. Raporti i koeficienteve është një me dhjetë të shpërndarë në 69 nivele të koeficienteve. Koeficienti më i lartë është 10, pozitë kjo që e mban vetëm presidenti i Kosovës, më pas është niveli 9, ku bëjnë pjesë kryetari i Kuvendit, kryeministri dhe kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Pra, ligji rregullonte rritjen e pagave për 70 për qind të punëtorëve në sektorin publik, kurse 30 për qind e tyre mbeten jashtë. Por, punëtorë në sektorë të ndryshëm publikë kishin shprehur pakënaqësi lidhur me përcaktimet dhe përfshirjen e tyre në ligj.

# Oda Ekonomike e Kosovës publikon të gjeturat e studimit për sektorin e riciklimit




**Prishtinë, 15 shtator** - Oda Ekonomike e Kosovës në mes të aktorëve të rëndësishëm, përfaqësuesve nga ministritë, ambasadat, donatorët dhe komuniteti i biznesit, ka publikuar të gjeturat kryesore të studimit bazë për sektorin e riciklimit.
Studimi ofron një pasqyrë të përgjithshme të zinxhirit të vlerës së riciklimit në Kosovë duke ofruar informata rreth gjendjes aktuale, nevojave, potencialit dhe barrierave të sektorit.
Studimi vë në pah nevojën për përkrahjen e mëtejshme të zhvillimit të sektorit të riciklimit, adresimin e sfidave dhe rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e këtij sektori drejt zhvillimit të qëndrueshëm.
Studimi do të ndihmojë që të hapet rruga për integrimin e konceptit të ekonomisë qarkore në modelet e biznesit në këtë sektor.
Ky studim ofron rekomandime për aktorët relevantë për përcaktimin e politikave që ndihmojnë zhvillimin e sektorit të riciklimit në Kosovë.
Përgatitja dhe publikimi i studimit është bërë në kuadër të projektit "Përfshirja e ekonomisë qarkore në sektorin privat të Kosovës" që zbatohet nga OEK, mbështetet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) dhe financohet nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Gjermanisë.

## Pensionistët i presin me pankarta deputetët, kërkojnë ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale

**Prishtinë, 15 shtator** - Me mesazhin "Dinjitet për pensionistët", dhjetëra pensionistë kanë qëndruar të enjten para Kuvendit të Kosovës. Me pankarta dhe disa prej tyre me lule në duar i kanë pritur deputetët, duke kërkuar prej tyre ndryshimin e Ligjit për Pensione.
Ditë më parë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kishte kërkuar mbështetjen e deputetëve të pozitës për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.
Deputeti Shemsedin Dreshaj, në konferencë për medie, ka thënë se me këtë propozim parashihet të largohet neni diskriminues, i cili parasheh që çdo person të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune para vitit 1999 në mënyrë që ta përfitojë pensionin kontributdhënës.



# Pse nuk mund të jemi të gjithë të pasur?



Nga J. Bradford DELONG

Më 6 shtator, shtëpia botuese "Basic Books" nxjerr në treg librin tim të ri "Rrugëtimi i vështirë drejt utopisë", një historia e "shekullit të gjatë XX", nga viti 1870 deri në 2010-ën. Aty unë argumentoj se pse ka ardhur koha të ndryshojmë mënyrën e të kuptuarit se ku nis realisht historia globale e ekonomisë.

Disa mund të përmendin vitin 1076, kur Kontradikta Evropiane e Investimeve, çimentoi idenë se ligji duhet të kufizojë edhe më të plotfuqishmit, në vend që të jetë thjesht një mjet në dispozicion të tyre. Një vit tjetër me rëndësi është edhe 1450, kur shpikja e shtypshkronjës sëlëvizshme nga Gutenberg si dhe Rilindja Evropiane, krijuan terrenin për ardhjen e epokës sëIluminizmit.

Dhe pastaj është edhe viti 1770, kur nisi Revolucioni Industrial. Nuk mund të vihet nëdyshim rëndësia e asaj që përfaqësojnë këto data. Por unë vetë zgjodha vitin 1870, pasi ai ka akoma më shumë rëndësi se të tjerët. Është momenti ku nisi të funksionojë laboratori i kërkimit industrial, korporata moderne dhe globalizimi i plotë.

Këto ishin institucionet që do të diktonin përparimin teknologjik, deri në dyfishimin e madhësisë së ekonomisë globale pas çdo gjenerate. Dhe kjo është në përgjithësi ajo që ndodhi gjatë viteve 1870-2010. Ky ritëm i paprecedentë i përparimit teknologjik, i dha njerëzimit fuqinë për ta shpërfillur më në fund parashikimet e zymta të Maltusit.

Rritja e popullsisë, nuk do të zhbënte më fitimet nga produktiviteti, për ta mbajtur botën të varfër. Inovacionet në teknologji, metodë dhe organizim, mundësuan zgjerimin e "byrekut ekonomik", në mënyrë që të gjithë të kenë mjaftueshëm.

Kjo do të thoshte se qeverisja nuk do të funksiononte më kryesisht si një makineri për nxjerrjen e burimeve, me anë të së cilës elita mund të rrëmbejë "mjaftueshëm" copa nga "byreku" me përmasa të pamjaftueshme për vete. Përkundrazi, qeveria dhe politika mund të fokusoheshin realisht drejt krijimit të një bote vërtet humane.

Trajektorja teknologjike e pas vitit 1870, e tejkaloi me shpejtësi çdo gjë që njerëzimi kishte imagjinuar deri në atë moment se do të nevojitej për arritjen e utopisë. Me zgjidhjen e problemit të pjekjes së një "byreku ekonomik" mjaftueshëm të madh, dukej se kishte marrëfund pjesa më e vështirë.

Gjithçka që duhej të bënte njerëzimi, ishte të kuptonte se si ta ndante, dhe më pas ta shijonte "byrekun" . Pra si ta shndërronim aftësinë tonë teknologjike në një jetë të lumtur, të shëndetshme dhe të sigurt për të gjithë. Këto probleme do të zgjidheshin edhe më shpejt, apo jo?

Në fakt, problemet e prerjes dhe shijimit të një "byreku ekonomik" në rritje të shpejtë, na kanë shqetësuar vazhdimisht. Për të kuptuar pse nuk kemi qenë kolektivisht në gjendje ta kuptojmë siç duhet, unë do të përmendja 4 mendimtarë të shquar në këtë fushë.

I pari është ekonomisti me origjinë austriake Jozef Shumpeter, që shpjegoi se si teknologjia moderne gjeneron pasuri të pamasë, përmes një procesi të "shkatërrimit krijues". Përparimi teknologjik dhe ai ekonomik, kërkon që industritë e vjetra, profesionet dhe modelet shoqërore të shkatërrohen rregullisht, për t'i hapur rrugë krijimeve të reja.

Pa dyshim që ky proces mund të jetë i dhimbshëm. Por kjo është gjithashtu arsyeja pse ka pasur më shumë ndryshime teknologjike që nga viti 1870 e deri më sot, sesa midis viteve 6000 Para Erës Sonë dhe vitit 1869. Mendimtari i dytë është Fridrih Engels, që përpunoi modelin marksist të superstrukturës në ekonomi.

""Superstruktura" përshkruan të gjithë shoqërinë, me rrjetet e saj personale, modelet sociologjike dhe institucionet politike, kulturore dhe më e rëndësishmja ekonomike. Sado të rëndësishme që janë këta elementë, që të gjitha ata mbështeten dhe duhet të jenë në përputhje me "bazën" teknologjike themelore të prodhimit.

Në çdo moment që nga viti 1870, çfarëdolloj softueri sociologjik që përdorte një shoqëri e caktuar, do të vjetërohej në mënyrë të pashmangshme, dhe do të rrëzohej brenda hapësirës së50 viteve, për shkak të ndryshimeve në harduerin themelor, të cilat nga ana e tyre u nxitën nga "shkatërrimi krijues" shumpeterian.

Mendimtari i tretë, është një ekonomist tjetër me origjinë austriake, Fridrih Von Hajek. Pikëpamja e tij bazë ishte se ekonomia e tregut, është një mekanizëm i pakrahasueshëm për krijimin e inovacionit dhe mobilizimin e fuqisë së trurit njerëzor për ta bërë botën më të pasur (me kushtin që të zbatohen të drejtat e pronës).

Por Hajek paralajmëroi se këto përfitime vijnë me një kosto të tmerrshme:nuk mund të pritet që tregu të ofrojë asnjë formë të drejtësisë sociale. Ai besonte fort se çdo përpjekje për të menaxhuar apo rregulluar tregun me qëllime të tilla në mendje, jo vetëm që do të dështonte, por do ta minonte aftësinë e tregut për të bërë atë që bën më së miri.

Kështu doktrina e tij krijoi moton:"Tregu jep, tregu merr:Bekuar qoftë emri i tij!". Çdo gjë tjetër do të na vendoste në "rrugën drejt robërisë". Më në fund, antropologu ekonomik hungarez Karl Polani, pa se vizioni i Hajek për një utopi të dhuruar nga tregu ishte i paqëndrueshëm për shkak të të qenit çnjerëzor.

Njerëzit duan të kenë një zë mbi vendimet se si përdoren burimet e shoqërisë së tyre. Ata do të kërkojnë që të ardhurat e tyre – por edhe të të tjerëve – të arrijnë një nivel minimal dinjitoz,dhe do të presin një shkallë të caktuar stabiliteti. Njerëzit priren t'i rezistojnë idesë se modeli i tyre i jetës, mund të shkatërrohet edhe nga vetëm ndonjë kozmopolit që i maksimizon fitimet e tij në anën tjetër të botës.

Për mirë a keq, të tillë janë njerëzit. Nëse të drejtat e pronës, janë vërtet të vetmet të drejta që kanë rëndësi, politika dhe shoqëria do të futen në një ngërç. Të katër mendimtarët na japin mundësi të kuptojmë pse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim aftësitë tona teknologjike për të ndërtuar një botë të barabartë dhe të lumtur.

Sigurisht, diagnoza është vetëm gjysma e betejës (dhe ndoshta më pak). Detyra e gjeneratave të ardhshme, është ta kuptojnë se si të bëhen aq shumë të aftë në prerjen dhe shijimin e "byrekut ekonomik", siç ishin gjeneratat e mëparshme që e bënë atë më të madh.

*Shënim: J.Bradford DeLong, profesor i ekonomisë në Universitetin e Kalifornisë, dhe bashkëpunëtor i Byrosë Kombëtare të Kërkimeve Ekonomike. Më herët ka qenëzëvendës/ndihmës Sekretar i Thesarit i SHBA-së gjatë administratës së Bill Klintonit. / "Project Syndicate" – Bota.al*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Tovërlani paraqitet si përzgjedhës i Kosovës U21

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Afrim Tovërlani është paraqitur si përzgjedhës i përfaqësueses së Kosovës U21. Në konferencën për medie, Tovërlani ka zbardhur listën e futbollistëve për kampin dhjetëditor në Antalia, ku do të zhvillohen edhe dy ndeshje miqësore. "Janë bërë një muaj e gjysmë qëkur jam emëruar përzgjedhës i Kosovës U21. Ndeshjet e para do të jenë më të vështira pasi ka disa prej futbollistëve që nuk i kam parë dhe nuk kam pasur bashkëpunim. Ky është grumbullimi i parë për mua. Të hënën udhëtojmë në Antalia dhe do të qëndrojmë dhjetë ditë ku do ta shoh për së afërmi shumicën e futbollistëve", ka thënë Tovërlani. Ai ka theksuar se lista aktuale nuk do të thotë se do të jetë e njëjtë për grumbullimin e radhës në nëntor. Sa iu përket synimeve për kualifikimet e ardhshme, ai ka thënë se më shumë do të mund të flasë pas grumbullimit të nëntorit, por që çdo gjë do të varet nga shorti që do të tërhiqet në muajin dhjetor, por edhe nga gjenerata e futbollistëve. Tovërlani ka thënë se pjesë e Përfaqësues U21 do të jenë të gjithë ata futbollistë që e meritojnë, pavarësisht nëse luajnë jashtë apo brenda Kosovës, derisa ka premtuar se do ta japë më të mirën e tij në drejtim të Kosovës U21.

**LISTA E FUTBOLLISTËVE**

Leo Besson, Rijad Bytyqi, Erion Avdija, Amar Gerxhaliu, Vleron Statovci, Arbnor Aliu, Argjend Pacolli, Erdin Dushi, Florian Haxha, Egzon Rexhaj, Elvis Letaj, Buron Humolli, Art Smakaj, Doni Arifi, Lulzim Peci, Adem Podrimaj, Milot Avdyli, Arlind Rexhepi, Norik Humolli, Besfort Zeneli, Edin Hyseni, Dion Krasniqi, Elidon Qenaj, Arian Llugiqi.




# Trepça '89 barazon me Ferizajn, Drenica mposht Dukagjinin



"Epoka e re"

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Të enjten janë zhvilluar dy ndeshjet e javës së shtatë në Superligën e Kosovës në futboll. Trepça '89 në fund shpëtoi nga humbja duke barazuar rezultatin ndaj Ferizajt (1-1), kurse Drenica e mposhti Dukagjinin (1-2) në Klinë. Në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë, pjesa e parë përfundoi 0-0, në pjesën e dytë golin e parë e shënuan mysafirët nëpërmjet Drilon Sadikut në minutën e 81-të. Ndërsa vendasit barazuan me golin e Gashit në fund të ndeshjes.
Në xhiron e radhës Trepça '89 luan kundër Dukagjinit, kurse Ferizaj e pret skuadrën kampione, Ballkanin. Në ndeshjen tjetër, Drenica e mposhti Dukagjinin me rezultat 1-2. Bintsoukas shënoi golin e parë në minutën e 12ë, kurse në minutën e 39, Vojvoda e shënoi golin e dytë. Katër minuta pasi filloi pjesa e dytë, Dukagjini e shënoi golin e parë nëpërmjet Otto John nga penalltia. Dukagjini do të luajë si mysafir i Trepçës '89 në fundjavë, kurse Drenica e pret në shtëpi Prishtinën.

**SUPERLIGA - Java 7**

| | |
|---|---|
| Dukagjini - Drenica | 1-2 |
| Trepça '89 - Ferizaj | 1-1 |
| Drita - Gjilani | 4-1 |
| Prishtina - Malisheva | 4-2 |
| Llapi - Ballkani (është shtyrë) | |



# Malisheva shkarkon Thaqin

